

**KREU I**  
**EMRI DHE FORMA E SHOQËRISË, SELIA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI**

**NENI 1**  
**EMRI DHE FORMA E SHOQËRISË**

- 1.1 Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është E.M.G-SEITAJ SHPK (më poshtë e quajtur "Shoqëria").
- 1.2 Shoqëria është e organizuar në formën e një shoqërie tregtare me përgjegjësi të kufizuar, në kuptim të Ligjit Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 i ndryshuar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 1.3 Në rast transferimi të veprimtarisë tregtare mund të ruhet i njëjti emërtim me kusht që personi juridik të shtojë në këtë emërtim një shënim i cili ka të bëjë me transferimin.

**NENI 2**  
**SELIA**

- 2.1.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Njesia me Nr.11/86-N12, Zona Kadastrale 8502, Lagja "22 Tetori", Berat.
- 2.2 Asambleja e ortakeve mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Përsonat përgjegjës për administrimin e Shoqërisë mund të çelin ose mbyllin degë dhe/ose zyra përfaqësimi, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

**NENI 3**  
**KOHËZGJATJA**

- 3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhe kohore me afat të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

**NENI 4**  
**OBJEKTI I SHOQËRISË**

- 4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, dhe në veçanti:

Bar-Restorante, Sherbim Delivery, Aktivitete te tjera te ngjashme me keto.

**KREU II**  
**KAPITALI I SHOQËRISË TRANSFERIMI I KUOTAVE FINANCIMI**

**NENI 5  
KAPITALI I SHOQËRISË**

**5.1** Kapitali i Shoqërisë është 100,000, ( njëqindë mijë) lekë, i përbërë nga 3 (tre) kuotë me vlerën 100,000 ( njëqindë mijë) Lekë. Ortaku **Znj.Loreta Seitaj** zotëron 1 kuotë që përfaqësohet 33.33% të kapitalit me vlerë 33,330 ( tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë) Lekë i cili është paguar tërësisht në para nga Ortaku **Znj.Loreta Seitaj**, shtetas Shqiptar, lindur në Lushnje më 2 Mars 1978, mbajtës i leternjoftimit Nr. 035064099 dhe nr ID: **H85302067E** ,person madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

Ortaku **Z.Edison Seitaj** zotëron 1 kuotë që përfaqësohet 33.33% të kapitalit me vlerë 33,330 ( tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë) Lekë i cili është paguar tërësisht në para nga Ortaku **Z.Edison Seitaj**, shtetas Shqiptar, lindur në Karkanjuz më 4 Nentor 1988, mbajtës i leternjoftimit Nr. 036087798 dhe nr ID: **I81104056J** ,person madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

Ortaku **Z.Marjus Seitaj** zotëron 1 kuotë që përfaqësohet 33.34% të kapitalit me vlerë 33,340 ( tridhjetë e tre mijë e treqind e dyzete) Lekë i cili është paguar tërësisht në para nga Ortaku **Z.Marjus Seitaj**, shtetas Shqiptar, lindur në Lushnje më 7 Prill 1989, mbajtës i leternjoftimit Nr. 036545435 dhe nr ID: **I90407060O**,person madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

**NENI 6  
TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT TËK TË TRETËT**

- 6.1** Kuotat e shoqërisë mund t'u transferohen lirisht të tretëve vetëm me miratimin nga Asambleja e ortakeve, sipas dispozitave ligjore në fuqi.
- 6.2** Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim, pranë një notëri dhe i njoftohet shoqërisë.
- 6.3** Transferimi i tyre, merr vlerë vetëm pas regjistrimit të kalimit të kuotave pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

**NENI 7  
BARRËT MBI KUOTAT E KAPITALIT**



- 7.1 Kuotat e kapitalit të Shoqërisë mund të rendohen lirisht me barrë siguruese apo të drejta të tjera reale.

**KREU III  
NDRYSHIMI I KAPITALIT**

**NENI 8**

- 8.1 Zmadhimi i kapitalit themeltar me anën e kontributëve në natyrë apo zvogëlimi i tij bëhet me miratimin e Asamblese se Ortakeve mbi bazën e një projekti të paraqitur nga eksperti kontabël i autorizuar dhe me kërkesën e Asamblese se Ortakeve apo Administratorit të Shoqërisë.
- 8.2 Zvogëlimi i kapitalit themeltar, bëhet në bazë të dispozitave të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

**NENI 9  
ZMADHIMI I KAPITALIT**

- 9.1 Asambleja e Ortakeve, mund të vendosë që rritja e kapitalit të bëhet dhe me rezervat dhe fitimet e pashpërndara të shoqërisë, gjendje të cilat figurojnë deri në datën 31 dhjetor të vitit/vitëve financiar/financiare paraardhës/paraardhëse. Kjo gjë bëhet vetëm pasi Asambleja e Ortakeve, me vendim të ketë miratuar llogaritë vjetore të shoqërisë për vitin/vitët e mbyllur/mbyllura financiar/financiare paraardhës /paraardhëse.
- 9.2 Pas marrjes së një vendimi të tillë, Asambleja e Ortakeve cakton një ekspert kontabël të regjistruar për vlerësimin e zmadhimit të kapitalit themeltar me rezervat dhe fitimet e pashpërndara të shoqërisë, gjendje të datës 31 dhjetor të vitit paraardhës.
- 9.3 Pas prezantimit të aktit të vlerësimit nga eksperti kontabël i regjistruar, Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë, me një vendim tjetër, përcakton mënyrën e rritjes së kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 9.4 Pas marrjes së vendimit të dytë nga Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë, e gjithë procedura e ndjekur në zbatim të këtij neni do të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9723 datë 03. 05. 2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".



**KREU IV**  
**ORGANIZIMI I SHOQËRISË**  
**NENI 10**  
**STRUKTURAT DREJTUESE DHE VENDIMMARRËSE**

- 10.1** Shoqëria tregtare E.M.G-SEITAJ SHPK ka si struktura drejtuese dhe vendimmarrëse :
- Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë si organi vendimmarrës për shoqërinë;
  - Administratorin

**NENI 11**  
**DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E ORGANIT VENDIMMARRËS**

- 11.1** Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë, si organ vendimmarrës për shoqërinë, është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
  - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raportëve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raportëve të ecurisë së veprimtarisë;
  - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
  - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

11.2 Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës "1" të këtij nëni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumentëve përkatës.

11.3. Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë do të regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Forma e regjistrit dhe mbajtja e vendimeve përcaktohen me vendim të Asamblese se Ortakeve të Shoqërisë. Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë, me vendim, mund të ngarkojë dhe një person fizik për mirëmbajtjen e regjistrit të mbledhjeve.

11.4 Nga ana e Asamblese se Ortakeve të Shoqërisë merren të gjitha masat përkatëse për regjistrimin e vendimeve të saj pranë organëve përkatëse shtetërore dhe sidomos në veçanti, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raportëve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- d) vendimet e marra në zbatim të nënit 9 të këtij statuti.

11.5 Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishtë pasur dijeni për të.

## NENI 12

### MBLEDHJA E ORGANIT VENDIMARRËS

12.1 Mbledhja e Asamblese se Ortakeve të Shoqërisë zhvillohet në rastet e përcaktuara nga Ligji Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 i ndryshuar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e ortakut të vetëm thirret dhe zhvillohet të paktën një herë në vit.

12.2 Mbledhja e Asamblese se Ortakeve të Shoqërisë thirret nga kryesisht nga Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë ,administratori apo dhe nga eksperti

kontabël i autorizuar kur ka nevojë për diskutime për çështje ekonomike që lidhen me shoqërinë.

- 12.3 Mbledhja e Asamblese se Ortakeve të Shoqerise,thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raportëve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 (tre) muajve në vazhdim.
- 12.4 Mbledhja e Asamblese se Ortakeve të Shoqerise thirret nga personat e tjerë të parashikuar nga pika 12.2 e këtij nëni jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar në mbledhjen e Asamblese se Ortakeve të Shoqerise. Mënyra e thirrjes së mbledhjes kryhet sipas përcaktimeve përkatëse të parashikuara Ligjin Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 i ndryshuar“Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

## KREU V

### ASAMBLEJA E ORTAKEVE, FINANCIMET

#### NENI 13

#### ASAMBLEJA E ORTAKEVE

- 13.1 Asambleja e Ortakeve të Shoqerise i Shoqërisë janë ortakët:

Ortaku **Znj.Loreta Seitaj** zotëron 1 kuotë që përfaqësohet 33.33% të kapitalit me vlere 33,330 ( tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë) Lekë i cili është paguar tërësisht në para nga Ortaku **Znj.Loreta Seitaj**, shtetas Shqiptar, lindur në Lushnje më 2 Mars 1978, mbajtës i leternjoftimit Nr. 035064099 dhe nr ID: **H85302067E** ,person madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

Ortaku **Z.Edison Seitaj** zotëron 1 kuotë që përfaqësohet 33.33% të kapitalit me vlere 33,330 ( tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë) Lekë i cili është paguar tërësisht në para nga Ortaku **Z.Edison Seitaj**, shtetas Shqiptar, lindur në Karkanjoz më 4 Nentor 1988, mbajtës i leternjoftimit Nr. 036087798 dhe nr ID: **I81104056J** ,person madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

Ortaku **Z.Marjus Seitaj** zotëron 1 kuotë që përfaqësohet 33.34% të kapitalit me vlere 33,340 ( tridhjetë e tre mijë e treqind e dyzete) Lekë i cili është paguar tërësisht në para nga Ortaku **Z.Marjus Seitaj**, shtetas Shqiptar, lindur në Lushnje më 7 Prill 1989, mbajtës i leternjoftimit Nr. 036545435 dhe nr ID: **I90407060O**,person madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

**NENI 14**  
**VENDIMET E ASAMBLESE SE ORTAKEVE**

- 14.1** Asambleja e Ortakeve të Shoqërise, në përputhje me legjislacionin shqiptar merr vendime në lidhje me: (i) ndryshimin e këtij Statuti, (ii) zmadhimin e zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, (iii) kalimin e kuotave të Shoqërisë, (iv) emërimin dhe shkarkimin e Administratoreve si edhe emërimin e shkarkimin e ekspërtit(ëve) kontabël të autorizuar, (v) miratimin e bilancit vjetor të Shoqërisë si edhe të çdo raporti tjetër financiar, (vi) shndërrimin, shpërndarjen dhe likuidimin e Shoqërisë, (vii) emërimin e likuidatorit(ëve) dhe çdo vendim tjetër që sipas ligjit i takon Ortakut të Vetëm.
- 14.2** Asambleja e Ortakeve të Shoqërise duhet të merren me shkrim dhe të regjistrohen në regjistrin e mbajtur pranë selisë së Shoqërisë.

**NENI 15**  
**TË DREJTAT DHE DETYRAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE**

- 15.1** Të drejtat dhe detyrat e Asamblese se Ortakeve të Shoqërise janë:
- Të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblese se Ortakeve të Shoqërise;
  - Të paraqesë pyetje me shkrim në lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqërisë;
  - Të informohet mbi përmbajtjen e raportit të administrimit, inventarët e llogaritë vjetore, tëkëstët e vendimeve të propozuara, si dhe raportin e ekspërtit kontabël;
  - Të përfitojë nga fitimi i shoqërisë;
  - Të kërkojë prishjen e shoqërisë në rrethana të caktuara;

**NENI 16**  
**FINANCIMI I SHOQËRISË**

- 16.1** Organi i Administrimit të Shoqërisë, në përputhje me dispozitat në fuqi, përveç rastëve të zmadhimit të kapitalit, ka të drejtë të kërkojë nga ortakët e shoqërisë fondet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë.
- 16.2** Financimet e mëtejshme të ortakeve në shoqëri do të jenë me shpërblim (intëresa) apo pa shpërblim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit do të lëvrohen këto fonde.

**KREU VI**  
**ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

**NENI 17**  
**ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

**17.1** Shoqëria administrohet nga 1 (një) Administrator i cili emërohet nga Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë rizgjedhje. Administratori i parë i Shoqërisë emërohet:

**Z.Edison Seitaj**, shtetas Shqiptar, lindur në Karkanjuz më 4 Nentor 1988, mbajtës i leternjoftimit Nr. 036087798 dhe nr ID: **I81104056J**, person madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

**17.2** Në zbatim të këtij neni, administratori i vetëm përfaqëson Shoqërinë kundrejt palëve të treta, përfshirë autoritetët publike dhe privatë, vendase ose të huaja, bankat, autoritetit tatimore dhe gjyqësore. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë sipas këtij akt themelimi dhe statuti e legjislacionit shqiptar.

**17.3** Administratori mund të ndërmarrë apo kërkojë kryerjen e të gjitha aktëve që konsideron të nevojshme për arritjen e objektit të Shoqërisë, përveç atyre që ligji apo statuti i rezervon Ortakut të Vetëm apo organëve të tjera të Shoqërisë.

**NENI 18**  
**TË DREJTAT DHE DETYRAT E ADMINISTRATORIT**

**18.1** Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentëve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumentë përpara Asamblese se Ortakeve të Shoqërisë për miratim;



- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në Ligjin Nr. 9723 datë 03. 05. 2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- e) raportoje përpara Asamblese se Ortakeve të Shoqërisë në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët;
- f) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

#### **NENI 19**

#### **PËRGJEGJËSIA E ADMINISTRATORIT**

- 19.1** Administratori është përgjegjës individualisht sipas rastit ndaj vetë shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

#### **NENI 20**

#### **SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORIT**

- 20.1** Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë përcakton shpërblimin e Administratorit të shoqërisë.

#### **KREU VII**

#### **KONTROLLI I KONTABËL I SHOQËRISË VITI FINANCIAR DHE BILANCI**

#### **NËNI 21**

#### **KONTROLLI KONTABËL**

- 21.1** Kontrolli i jashtëm kontabël i Shoqërisë kryhet nga Ekspertë Kontabël të Regjistruar, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë do të emërojë një apo më shumë ekspertë kontabël në ato rastë kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

**21.2** Për kompetencat, detyrimet, përgjegjësitë, zëvendësueshmërinë, tërheqjen, shkarkimin dhe shpërblimi i tij zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

**NENI 22**

**VITI FINANCIAR**

**22.1** Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

**NENI 23**

**BILANCI DHE REZERVAT**

**23.1** Me mbylljen e secilit vit financiar, Administratori merr masat e nevojshme për hartimin e bilancit të aktivitetit për vitin financiar të mbyllur, në mënyrë që Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë të vendosë mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme të tij brenda afatëve të përcaktuara nga ligji.

**23.2** Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë vendos mbi ndarjen e dividendëve që rezultojnë si fitime sipas bilancit të miratuar rregullisht, pasi nga këto shuma të jenë zbritur humbjet e mundshme të vitëve të mëparshme.

**23.3** Asambleja e Ortakeve të Shoqërisë në çdo moment mund të vendosë krijimin e rezervave, si edhe masën e tyre.

**NENI 24**

**PUNËSIMI NË SHOQËRI**

**24.1** Të gjithë personat që do të punësohen pranë kësaj shoqërie, punësimi i tyre do të bëhet mbi bazën e kontratës individuale apo kolektive, sipas rastit, në të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet ligjore të secilës palë si dhe paga mujore në përputhje me legjislacionin shqiptar në këtë fushë.

**KREU VIII**

**PRISHJA DHE NJOFTIMET**

**NENI 25**

**PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

- 25.1** Shoqëria mund të prishet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak, si në rast falimentimi, privim të të drejtave për të ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore dhe faktorë të tjerë që nuk varen nga Asambleja e Ortakeve të Shoqërise.
- 25.2** Shoqëria hyn në fazën e likuidimit qysh në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi, Asambleja e Ortakeve të Shoqërise emëron një ose disa likuidatorë, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitet dhe pasivit të Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacionëve të likuidimit dhe afatin e nëvojshëm të përfundimit të tyre. Shoqëria prishet në këto rastë:
- Kur nuk mund të përmbushet objekti për të cilin është krijuar shoqëria;
  - Me vullnëtin e ortakëve;
  - Me vendim të Gjykatës
  - Shkaqe të tjera të parashikuara në ligj

## NENI 26

### PROCEDURAT QË NDIQEN

- 26.1** Likuidimi i shoqërisë tregtare E.M.G-SEITAJ SHPK vendoset nga Asambleja e Ortakeve të Shoqërise kur prishet shoqëria.
- 26.2** Likuidimi i shoqërisë do të bëhet duke zgjedhur procedurën e zakonshme të parashikuar në Ligjin Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 26.3** Në qoftë se Asambleja e Ortakeve të Shoqërise, për mbylljen e parashikuar, nuk mund të marrë vendim ose ai nuk pranon të miratojë llogaritë e likuiduesit vendimi merret nga Gjykata me kërkesën e likuiduesit ose çdo personi të interesuar.
- 26.4** Nëse nuk është proceduar si më sipër Gjykata me miratimin e Asambleja e Ortakeve të Shoqërise zbaton dispozitat ligjore dhe në se miratimi nuk



është dhënë deri në seancën e parë gjyqësore ky miratim prezumohet i mirëqenë.

- 26.5** Në fund të procesit të likuidimit thirret Asambleja e Ortakeve të Shoqërise për të vendosur në lidhje me bilancin financiar përfundimtar.

## **NENI 27**

### **NJOFTIMET**

- 27.1** Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera që u jepen personave ose që bëjnë personat sipas Statutit do të kryhen me shkrim ose përmes komunikimit elektronik (nëse ka) dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen në adresat e deklaruara prej tyre pranë Administratorit të Shoqërisë.
- 27.2** Njoftimet zyrtare të komunikimeve me anë të mjetëve elektronike vërtëtohen sipas Legjislacionit për nënshkrimin elektronik dhe dërgohen në adresat elektronike të deklaruara prej tyre.
- 27.3** Në rastin kur një kuotë zotërohet nga më shumë se një person, të gjitha njoftimet do ti drejtohen përfaqësuesit të bashkëzotëruesve të kuotës.

## **KREU IX**

### **BASHKIMI DHE NDARJA E SHOQËRISË**

#### **NENI 28**

- 28.1** Shoqëria E.M.G-SEITAJ SHPK me anë të bashkimit mund t'i kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ato themelojnë që ushtron të njëjtin aktivitet.
- 28.2** Gjithashtu shoqëria E.M.G-SEITAJ SHPK me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërive të reja.
- 28.3** Në rast se operacioni përfshin krijimin e shoqërive të reja secila prej tyre themelohet sipas rregullave që i për E.M.G-SEITAJ SHPK shoqërisë që do të krijohet.

- 28.4 Transferimi i plotë i aktivitetit të shoqërisë apo kontributi në aktiv të një shoqërie tjetër, veçanërisht me anë të procesit të bashkimit duhet të autorizohet nga Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë.

**KREU X**  
**DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**  
**NENI 29**  
**LIGJI I ZBATUESHËM**

- 29.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë dhe Statut dhe me ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

**NENI 30**

- 30.1 Ky Statut përpilohet në 4 (katër) kopje origjinale secili me të njëjtën vlerë ligjore. Njëri prej tyre ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë


**Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë**

**E.M.G-SEITAJ SHPK**


**Loreta Seitaj**

Loreta Seitaj 

**Edison Seitaj**

EDISON SEITAJ 

**Marjus Seitaj**

Marjus Seitaj 

Datë 23.04.2024

